



**Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve
Drejtoria e Profesioneve dhe Kualifikimeve Profesionale**

STANDARDI I KUALIFIKIMIT PROFESIONAL “MOBILIERI DHE TAPICERI”

Niveli III në KSHK¹, referuar nivelit III të KEK²

C3-III-26

Tiranë 2026

¹ Korniza Shqiptare e Kualifikimeve

² Korniza Evropiane e Kualifikimeve

Përmbajtje

Emërtimi i kualifikimit	4
Kodi.....	4
Kohëzgjatja	4
Niveli.....	4
Qëllimi	4
Kriteret e përgjithshme të pranimi	4
Mundësitë e kualifikimit të mëtjshëm dhe të punësimit	4
Struktura e kualifikimit	5
KOMPETENCA TË PËRGJITHSHME	5
NJËSITË E TË NXËNIT TË KUALIFIKIMIT PROFESIONAL:	5
NjN-03-III-0552-26 Klasifikimi dhe dizajni i mobilieve	5
Rezultatet e të nxënit në njohuri	5
Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale	6
Kriteret e vlerësimit	6
NjN-03-III-0553-26 Parapërgatitja për prodhimin e produktit	6
Rezultatet e të nxënit në njohuri	6
Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale	7
Kriteret e vlerësimit	7
NjN-03-III-0554-26 Planifikimi dhe organizimi i vendit të punës në mobilieri dhe tapiceri	8
Rezultatet e të nxënit në njohuri	8
Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale	8
Kriteret e vlerësimit	8
NjN-03-III-0555-26 Materialet për prodhimin e mobilieve	9
Rezultatet e të nxënit në njohuri	9
Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale	9
Kriteret e vlerësimit	9
NjN-03-III-0556-26 Mjetet, pajisjet dhe teknikat e përdorimit të tyre	11
Rezultatet e të nxënit në njohuri	11
Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale	11
Kriteret e vlerësimit	12
NjN-03-III-0557-26 Makineritë dhe përdorimi i tyre	12
Rezultatet e të nxënit në njohuri	12

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale	13
Kriteret e vlerësimit	13
NjN-03-III-0558-26 Teknologjia e prodhimit të mobilieve	14
Rezultatet e të nxënit në njohuri	14
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale	14
Kriteret e vlerësimit	15
NjN-03-III-0559-26 Punime të strukturës mbajtëse dhe të pjesës së butë në mobiliet e tapicuara	15
Rezultatet e të nxënit në njohuri	15
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale	16
Kriteret e vlerësimit	16
NjN-03-III-0560-26 Riparimi i defekteve dhe restaurimi i mobilieve.....	17
Rezultatet e të nxënit në njohuri	17
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale	17
Kriteret e vlerësimit	18
NjN-24-III-0492-26 Sipërmarrje, komunikim dhe edukim karriere	18
Rezultatet e të nxënit në njohuri	18
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale	20
Kriteret e vlerësimit	20
NjN-03-III-0561-26 Siguria në punë dhe mbrojtja e mjedisit në mobilieri dhe tapiceri.....	22
Rezultatet e të nxënit në njohuri	22
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale	22
Kriteret e vlerësimit	22
Njësitë e të nxënit, peshat dhe kodet përkatëse:	23
Modalitetet e vlerësimit	24
Informacion shtesë	24
SHËNIM	24

Emërtimi i kualifikimit	“Mobilieri dhe tapiceri”			Kodi
Kohëzgjatja	3300-4500 orë nacionale	Niveli	III KSHK, referuar nivelit III të KEK,	C3-III-26
Qëllimi:	Qëllimi kryesor i kualifikimit profesional “Mobilieri dhe tapiceri”, niveli III në KSHK, referuar nivelit III të KEK, është <i>“zhvillimi i personalitetit të individit për të jetuar në përshtatje me botën që e rrethon dhe përgatitja e tij për t’u punësuar në veprimtaritë profesionale që lidhen drejtpërdrejt me profilin “Mobileri dhe tapiceri”.</i> Zhvillimi te individi i ndjenjës së vetëbesimit, kultivimi i vullnetit të lirë në marrjen e vendimeve, nxitja e gatishmërisë për të nxënë gjatë gjithë jetës dhe për t’u zhvilluar individualisht në drejtimet emocionale, intelektuale dhe në shkallë të gjerë njohurish profesionale, janë sfida të rëndësishme për arritjen e këtij qëllimi.			
Kriteret e përgjithshme të pranimit:	Në shkollat që ofrojnë arsim profesional në kualifikimin “Mobilieri dhe tapiceri” niveli III në KSHK, kanë të drejtë të regjistrohen të gjithë të rinjtë që: - kanë mbaruar arsimin e detyruar 9-vjeçar; - janë të aftë fizikisht dhe mendërisht të përballojnë kërkesat e këtij niveli të arsimit profesional.			
Mundësitë e kualifikimit të mëtejshëm dhe të punësimit:	Pas përfundimit me sukses të kualifikimit profesional “Mobilieri dhe tapiceri”, niveli III në KSHK, me kohëzgjatje 3 vite shkollore, pas përfundimit të arsimit bazë, individit pajiset me certifikatë profesionale të maturës shkollore profesionale dhe suplementin përkatës ose del në tregun e punës si punonjës i kualifikuar. Ky arsimim i jep mundësi individit t’i drejtohet tregut të punës për t’u punësuar ose vetëpunësuar në ndërmarrje të ndryshme që kanë veprimtari për prodhime mobilierie/tapicerie, në repartet e makinerive të përpunimit të drurit, në montimin e mobilie, lyerjen dhe lustrimin, në repartet e tapicerisë, në mirëmbajtjen e mobilie, në njësi të shitjes së materialeve të mobilierisë apo të shitjeve të mobilie etj. Gjithashtu, përfundimi i këtij niveli lejon kalimin në nivel më të lartë të arsimit profesional, në nivelin IV në KSHK, arsim profesional njëvjeçar (nivel teknik/menaxherial), me qëllim përfitimin e diplomës së “Maturës Shtetërore Profesionale” ose në kursin urë, të përgjithshëm, dhe pas përfundimit të njërit nga këto kualifikime mund të vazhdojë studime pas të mesme ose universitare.			
Ofruesit	Ky kualifikim duhet të ofrohet nga ofrues të akredituar në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi për arsimin dhe formimin profesional.			
Data e validimit				
Data e miratimit				
Variantet e mëparshme				

STRUKTURA E KUALIFIKIMIT

Në përfundim të kualifikimit profesional në drejtimin “Mobilieri dhe tapiceri” niveli III në KSHK, referuar nivelit të III të KEK, individit duhet të zotërojë njohuritë, shprehjet profesionale dhe kompetencat e përgjithshme të ndara sipas njësive të të nxënit të mëposhtme:

KOMPETENCA TË PËRGJITHSHME

Rezultatet e të nxënit të kompetencave të përgjithshme janë të vlefshme për të gjitha njësitë e të nxënit.

1. Të komunikojë në mënyrë korrekte me shkrim e me gojë për të shprehur mendimet dhe ndjenjat e tij, si dhe për të argumentuar opinione për çështje të ndryshme;
2. Të përdorë burime dhe teknika të ndryshme të mbledhjes dhe të shfrytëzimit të informacioneve të nevojshme për zhvillimin e tij personal dhe profesional;
3. Të nxisë potencialin e tij/saj të brendshëm në kërkim të vazhdueshëm për zgjidhje të reja më efektive dhe më eficiente;
4. Të angazhohet fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme në kontekstin profesional, personal dhe shoqëror;
5. Të respektojë rregullat dhe parimet e një bashkëjetese demokratike në kontekstin e integriteteve lokale, rajonale;
6. Të tregojë vetëkontroll gjatë ushtrimit të veprimtarive të tij/saj;
7. Të organizojë në mënyrë të drejtë procesin e të nxënit të tij/saj dhe të shfaqë gatishmërinë dhe vullnetin për të nxënë gjatë gjithë jetës;
8. Të respektojë parimet e punës në grup dhe të bashkëpunojë aktivisht në arritjen e objektivave të pranuar;
9. Të demonstrojë aftësi për të përmbushur detyrat brenda afateve sipas një plani të caktuar;
10. Të manifestojë guxim dhe aftësi sipërmarrëse për të ardhmen e tij;
11. Të marrë nisma për të bashkëpunuar me individë apo grupe;
12. Të demonstrojë sjellje të përgjegjshme dhe etike në veprimtari shkollore, profesionale dhe komunitet;
13. Të demonstrojë aftësi për të punuar në mënyrë të pavarur dhe për qenë pjesëmarrës proaktiv në grup;
14. Të pranojë dhe të promovojë risitë dhe ndryshimet;
15. Të vlerësojë dhe vetëvlerësojë nisur nga kritere të drejta si bazë për të përmirësuar dhe çuar më tej arritjet e tij, për t'u përshtatur me evolucionin teknologjik.

NJËSITË E TË NXËNIT TË KUALIFIKIMIT PROFESIONAL:

Standardet e kualifikimit hartohen në bazë të rezultateve të të nxënit (kompetenca të përgjithshme, njohuri dhe shprehje profesionale).

NjN-03-III-0552-26 Klasifikimi dhe dizajni i mobilieve

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të përshkruajë zhvillimin e mobilieve në periudha të ndryshme historike;
2. Të identifikojë faktorët teknikë që përcaktojnë etapat e zhvillimit të mobilieve;
3. Të klasifikojë mobilet sipas stilit;

4. Të klasifikojë mobilet sipas funksionit;
5. Të klasifikojë mobilet sipas materialit/materialeve;
6. Të klasifikojë mobilet sipas llojit të punimit;
7. Të identifikojë strukturën e mobilieve korpusore dhe atyre të tapicuara;
8. Të identifikojë teknikat tradicionale dhe moderne të punimit të mobilieve;
9. Të shpjegojë parimet bazë të dizajnit në mobileri (linjë, formë, proporcion, ngjyrë, funksion, balancë, harmoni, kontrast);
10. Të shpjegojë rëndësinë e kombinimit të ngjyrave, ndriçimit dhe materialeve në krijimin e një ambienti harmonik;
11. Të shpjegojë lidhjen midis stilit të mobilieve dhe arkitekturës së ambientit;
12. Të shpjegojë rëndësinë e zbatimit të përmasave standarde të mobilieve;
13. Të përshkruajë rëndësinë e komoditetit në funksion të antropometrisë humane;
14. Të përshkruajë mënyrat e mirëpërdorimit të mobilieve.

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale

1. Të klasifikojë mobilet sipas stileve përkatëse.
2. Të zbërthejë mobilien në komponentët kryesorë;
3. Të dizajnojë mobilien në harmoni me interierin duke zbatuar parimet bazë, kombinuar ngjyrat, ndriçimin, materialet etj.

Kriteret e vlerësimit

- Identifikon saktë karakteristikat dalluese të secilës periudhë;
- Identifikon faktorët teknikë (teknologjia, materialet, prodhimi) sipas periudhës dhe ndikimit në dizajn;
- Vendos saktë mobiljen në stilin përkatës duke e argumentuar zgjedhjen;
- Dallon saktë funksionet e mobilies;
- Identifikon materialet (dru, metal, plastikë, etj.);
- Vlerëson vetitë bazë të materialeve;
- Lidh vetitë bazë të materialeve me përdorimin në mobileri;
- Identifikon tipologjinë e punimit sipas llojit të teknologjisë së prodhimit;
- Dallon saktë elementët strukturorë të mobilieve;
- Përcakton saktë teknikat e punimit (tradicionale vs moderne);
- Aplikon saktë parimet e dizajnit të mobilieve;
- Aplikon saktë kombinimin e ngjyrave, ndriçimit dhe materialeve;
- Bën harmonizimin e stilit të mobilies me arkitekturën e ambientit;
- Aplikon dimensionet standarde të mobilieve;
- Lidh saktë përmasat e mobilies me antropometrinë humane (trupin e njeriut).

NjN-03-III-0553-26 Parapërgatitja për prodhimin e produktit

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të përshkruajë llojet e matjeve lineare, mënyrat e realizimit të tyre;
2. Të përshkruajë rëndësinë e llogaritjeve matematikore në funksion të matjeve;
3. Të përshkruajë rëndësinë dhe qëllimin e vizatimit teknik;
4. Të listojë veglat dhe pajisjet e vizatimit teknik;

5. Të lexojë simbolet dhe shenjat dalluese që përdoren në skema të ndryshme të objekteve të thjeshta;
6. Të përshkruajë shkallët e paraqitjes së trupave në vizatimin teknik;
7. Të përshkruajë teknikat e vizatimit të lirë (perspektiva);
8. Të përshkruajë teknikat e vizatimit teknik manual;
9. Të përshkruajë skica detalesh duke përdorur standardet për paraqitjen;
10. Të interpretojë skica dhe vizatime teknike të detaleve dhe objekteve;
11. Të diferencojë skicën e thjeshtë nga vizatimi teknik i objekteve;
12. Të përshkruajë vizatime të bashkimeve të thjeshta detalesh;
13. Të interpretojë vizatimet e pamjeve, prerjeve në plane të ndryshme të objekteve prej druri;
14. Të përshkruajë skema të thjeshta të paraqitura në aksonometri;
15. Të interpretojë paraqitjen e mbishtesave për punim, në vizatimet e detaleve prej druri;
16. Të përshkruajë rëndësinë e vizatimeve me kompjuter dhe programet përkatëse;
17. Të përshkruajë teknikat e vizatimit teknik digjital (AutoCAD, Sketchup etj.);
18. Të shpjegojë mënyrën e organizimit të punës dhe parashikimit të kohës së nevojshme për realizimin e saj;

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale

1. Të kryejë matje duke përdorur pajisjet matëse, shënjuese etj;
2. Të realizojë skica teknike manuale dhe digjitale;
3. Të zbërthejë një objekt në detale;
4. Të kryejë llogaritje bazë teknologjike (sasinë e materialeve, kosto, kohën e prodhimit, etj).

Kriteret e vlerësimit

- Kryen matje të sakta;
- Përdor saktë pajisjet matëse, në përshtatje të standardeve metodologjike respektive;
- Përdor saktë veglat dhe pajisjet e vizatimit teknik konform standardeve metodologjike respektive;
- Lexon simbolet dhe shenjat dalluese që përdoren në skema të ndryshme të objekteve të thjeshta, sipas manualeve të standartizuara;
- Aplikon saktë shkallët e paraqitjes së trupave në vizatimin teknik sipas standardit;
- Realizon vizatim të lirë (perspektiva);
- Realizon skica teknike manualisht, sipas standardit;
- Zbërthen skica detalesh;
- Realizon saktë vizatime të bashkimeve detalesh;
- Vizaton “saktë” skema të thjeshta të paraqitura në aksonometri sipas udhëzimeve;
- Aplikon mbishtesat për punim në vizatimet e detaleve prej druri sipas udhëzimeve;
- Realizon skica teknike duke aplikuar programet kompjuterike (AutoCAD, Sketchup etj.);
- Llogarit saktë nevojat e sasisë për lëndë të parë;
- Përcakton pjesët përbërëse të produktit;
- Përcakton rendin teknologjik të veprimeve, sipas procedurës teknologjike;
- Llogarit saktë nevojat e sasisë për materiale ndihmëse;
- Llogarit saktë kohën e nevojshme për prodhimin e produktit;

NjN-03-III-0554-26 Planifikimi dhe organizimi i vendit të punës në mobilieri dhe tapiceri

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të përshkruajë shtrirjen teknike të prodhimit të mobilieve;
2. Të përshkruajë mënyrën e organizimit të kompanive/ndërmarrjeve të prodhimit të mobilieve;
3. Të listojë metodat e komunikimit teknik;
4. Të përshkruajë specifikat dhe performancën e produkteve;
5. Të shpjegojë normat e konsumit për materialet që përdoren në mobilieri dhe tapiceri;
6. Të përshkruajë mënyrën dhe rëndësinë e ruajtjes së materialeve në magazinë;
7. Të përshkruajë organizimin optimal të magazinës;
8. Të përshkruajë rëndësinë dhe mënyrat e organizimit të hapësirës së punës në mënyrë ergonomike;
9. Të përshkruajë format e bashkëpunimit me specialistë të tjerë;
10. Të përshkruajë kriteret e standardizuara të ndriçimit, ventilimit dhe higjienës në punë, si dhe rëndësinë e zbatimit të tyre;
11. Të përshkruajë mënyrën e hartimit të dokumentacionit teknik dhe profesional;
12. Të përshkruajë format e raportimit dhe rëndësinë e tij.

Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale

1. Të kryejë planifikimin dhe organizimin e punës në repartin e prodhimit;
2. Të planifikojë bazën materiale të nevojshme;
3. Të marrë masa për kushte optimale dhe të sigurta pune;
4. Të bashkëpunojë me kolegë, klientë dhe të tretë;
5. Të dokumentojë dhe raportojë në mënyrë të plotë dhe në kohë për punën;

Kriteret e vlerësimit

- Identifikon saktë fazat kryesore të procesit të prodhimit.
- Organizon strukturën e prodhimit në repart, sipas teknologjisë dhe shkallës së përdorimit të makinerive;
- Përcakton detyrat dhe përgjegjësitë sipas procesit të prodhimit;
- Organizon dokumentacionin teknik të repartit;
- Komunikon me terma teknike dhe të përshtatshëm gjatë veprimtarive;
- Vlerëson performancën e produkteve në bazë të kriterëve funksionale dhe cilësore;
- Krahason produkte të ndryshme duke analizuar dallimet në specifika dhe cilësi.
- Llogarit saktë normën e konsumit e lëndës së parë;
- Llogarit saktë sasinë e materialeve për një produkt të caktuar, duke marrë parasysh humbjet;
- Identifikon saktë dhe në mënyrë të plotë faktorët që ndikojnë në konsum, si teknologjia, cilësia e materialit dhe mënyra e punës;
- Ruan materialet referuar tipologjisë dhe karakteristikave të tyre;
- Merr masa për ruajtjen e parametrave klimatikë (lagështia relative e ajrit, temperatura, siguria kundër zjarrit, kundër sulmit biologjik etj.) në ambientet e magazinimit;
- Sistemon materialet sipas kategorive, përmasave dhe përdorimit të tyre;
- Siguron akses të lehtë, kontroll dhe siguri në magazinë për përdorim efikas të materialeve.

- Organizon vendin e punës referuar parimeve të ergonomisë;
- Bashkëpunon në mënyrë profesionale me kolegë, klientë dhe të tretë;
- Promovon punën në ekip duke dhënë shembuj konkretë materiave të tjera të situatave reale ose të simuluar.
- Zbaton më rigorozitet higjienën në punë;
- Siguron ndriçim dhe ventilim të vendit të punës;
- Harton dokumente teknike të qarta, të sakta dhe të strukturuar sipas kërkesave;
- Përdor formatin dhe terminologjinë profesionale në hartimin e dokumentacionit;
- Plotëson dokumentacionin teknik në përputhje me detyrën dhe standardet e kërkuara.
- Harton periodikisht raporte pune duke përfshirë progresin, materialet e përdorura dhe problematikat e hasura;
- Paraqet informacion të qartë dhe të strukturuar në raport;
- Raporton në kohë duke zbatuar afatet e dorëzimit.

NjN-03-III-0555-26 Materialet për prodhimin e mobilieve

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të listojë llojet kryesore të drurit, veçoritë dhe përdorimet e tyre;
2. Të listojë llojet e materialeve me bazë druri, veçoritë dhe përdorimet e tyre;
3. Të përshkruajë lloje të materialeve të tjera (xham, mermer, HPL etj.) që përdoren në kombinim me drurin;
4. Të listojë llojet e ngjitësve të drurit dhe karakteristikat e tyre;
5. Të listojë llojet e materialeve llustruese të drurit dhe karakteristikat e tyre;
6. Të listojë llojet e bojrave të drurit dhe karakteristikat e tyre;
7. Të listojë llojet e holluesve dhe katalizatorëve, si dhe karakteristikat e tyre;
8. Të listojë llojet e letrave të zumparimit dhe hapësirat e përdorimit të tyre;
9. Të listojë llojet e stukove, funksionimin dhe aplikimin e tyre;
10. Të listojë llojet e astarëve, funksionimin dhe aplikimin e tyre;
11. Të listojë llojet e sistemeve mbajtëse elastike (rripa, susta, shirita elastikë etj.) dhe mënyrat e montimit të tyre;
12. Të listojë llojet dhe karakteristikat e materialeve mbushëse (sfungjer, fibër, vatinë, lateks etj.), si dhe përdorimet e tyre;
13. Të listojë llojet e materialeve të veshjes (pëlhurë, lëkurë etj.) vetitë dhe përdorimet e tyre;
14. Të përshkruajë llojet e aksesorëve metalikë që përdoren në mobilie dhe funksionimin e tyre;
15. Të përshkruajë llojet e aksesorëve plastikë që përdoren në mobilie dhe funksionimin e tyre;
16. Të përshkruajë standardet e cilësisë referuar lëndës së parë dhe asaj ndihmëse.

Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale

1. Të identifikojë materialet sipas llojit që përdoren në prodhimin e mobilieve;
2. Të përcaktojë vetitë bazë të materialeve që përdoren në prodhimin e mobilieve;
3. Të përgatitë tretësirat ngjitëse dhe llustruese për aplikim;
4. Të aplikojë ngjitësat dhe tretësirat llustruese gjatë prodhimit të mobilieve;
5. Të identifikojë aksesorët metalikë/plastikë;

Kriteret e vlerësimit

- Identifikon saktë llojet kryesore të drurit;

- Vlerëson veçoritë fizike, mekanike dhe teknologjike të llojeve kryesore të drurit;
- Përcakton saktë përdorimin në mobilie të llojit drusor;
- Identifikon saktë tipet kryesore të materialeve me bazë druri që përdoren në fushën e mobilerisë dhe tapicerisë;
- Vlerëson veçoritë fizike, mekanike dhe teknologjike të materialeve me bazë druri që përdoren në fushën e mobilerisë dhe tapicerisë;
- Përcakton saktë përdorimin në mobilie referuar materialeve me bazë druri;
- Identifikon saktë llojet e ngjitësave kryesorë që përdoren në fushën e mobilerisë dhe tapicerisë;
- Vlerëson karakteristikat teknologjike të ngjitësave;
- Përzgjedh saktë ngjitësin për përdorimin referuar kushteve të aplikimit;
- Identifikon saktë llojet kryesorë të materialeve lustruese që përdoren në mobileri;
- Vlerëson karakteristikat teknologjike të materialeve lustruese;
- Përzgjedh saktë materialin lustrues për përdorimin referuar kushteve të aplikimit;
- Identifikon saktë llojet e bojrave të drurit që përdoren në mobileri;
- Vlerëson karakteristikat teknologjike të bojrave të drurit;
- Përzgjedh saktë bojën për përdorimin referuar kushteve të aplikimit;
- Identifikon saktë llojet kryesorë të holluesve dhe katalizatorëve të bojrave dhe llaqeve që përdoren në mobileri;
- Vlerëson saktë funksionin dhe karakteristikat teknologjike të holluesve dhe katalizatorëve;
- Përzgjedh saktë holluesin dhe/ose katalizatorin për përdorimin referuar sistemit specifik të bojës/llakut;
- Identifikon gradimet e letrës së zumparimit sipas teknologjisë respektive;
- Përdor letrën e zumparimit sipas teknologjisë respektive;
- Identifikon llojet e stukove që përdoren në sektorin e prodhimit të mobilie;
- Vlerëson saktë funksionin e stukove referuar vetive të tyre dhe kushteve të aplikimit (mbushje, nivelim);
- Identifikon llojet e astarëve që përdoren në sektorin e prodhimit të mobilie;
- Vlerëson saktë funksionin e astarëve referuar vetive të tyre dhe kushteve të aplikimit (bazë për bojë);
- Identifikon llojet e mbajtëseve elastike që përdoren në sektorin e prodhimit të mobilie të tapicuara (rripa, susta, etj.);
- Vlerëson saktë funksionin dhe vetitë e mbajtëseve elastike;
- Identifikon llojet e materialeve mbushëse që përdoren në sektorin e prodhimit të mobilie të tapicuara (sfungjer, lateks, etj.);
- Vlerëson saktë funksionin dhe vetitë e materialeve mbushëse;
- Identifikon llojet e materialeve veshëse që përdoren në sektorin e prodhimit të mobilie të tapicuara (pëlhurë, lëkurë, etj.);
- Vlerëson saktë funksionin dhe vetitë e materialeve veshëse;
- Identifikon aksesorët metalikë që përdoren në sektorin e prodhimit të mobilie (mentesha, vida, shina, mekanizma të ndryshëm, etj.), sipas llojit të tyre;
- Vlerëson saktë funksionin dhe vetitë e aksesorëve metalikë;
- Identifikon aksesorët plastikë që përdoren në sektorin e prodhimit të mobilie, sipas llojit;
- Vlerëson saktë funksionin dhe vetitë e aksesorëve plastikë;
- Respekton standardet bazë të drurit që përdoren në sektorin e prodhimit të mobilie;

- Respekton standardet e materialeve me bazë druri që përdoren në sektorin e prodhimit të mobilie;
- Respekton standardet bazë të materialeve ndihmëse që përdoren në sektorin e prodhimit të mobilie;

NjN-03-III-0556-26 Mjetet, pajisjet dhe teknikat e përdorimit të tyre

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të përshkruajë mjetet dhe instrumentet matëse e shënjuese dhe përdorimin e tyre;
2. Të përshkruajë mjetet dhe instrumentet nivelues (analog dhe digjital), si dhe përdorimin e tyre;
3. Të përshkruajë mjetet, instrumentet dhe pajisjet që përdoren në tharjen e lëndës drusore;
4. Të përshkruajë veglat e dorës së punës, llojet dhe përdorimet e tyre (sharrë dore, daltë, zdrukth dore, morsetat shtrënguese etj.);
5. Të përshkruajë mjetet elektrike të dorës, llojet, funksionimet dhe përdorimet e tyre (trapano, vidator, zdrukth elektrik; frezë dore, zumpare orbitale me presion ajri, sharrë cirkulare dore etj.);
6. Të rendisë instrumentet e dorës për axhustim dhe relevim të mjeteve elektrike;
7. Të përshkruajë llojet e pajisjeve (pajisjet e transportit të brendshëm, ventilimit, rrjetit elektrik etj.) që përdoren në repartet e prodhimit të mobilie;
8. Të listojë llojet e mjeteve dhe pajisjeve që përdoren për patinim sipas funksionimit të tyre;
9. Të përshkruajë llojet e mjeteve dhe pajisjeve për bojatisje, si dhe përdorimin e tyre;
10. Të përshkruajë llojet e mjeteve dhe pajisjeve për lustrim të sipërfaqeve të drurit si dhe përdorimin e tyre;
11. Të listojë llojet e mjeteve dhe pajisjeve gjatë proceseve të imitimit të drurit;
12. Të përshkruajë llojet e pajisjeve të presimit si dhe funksionimin e tyre;
13. Të përshkruajë llojet e instrumenteve prerës, dhe përdorimin e tyre;
14. Të identifikojë llojet e veglave dhe pajisjeve të mpërshjes së instrumenteve prerës dhe përdorimin e tyre;
15. Të listojë mjetet e punës për procesin e vendosjes së elementeve dekorativë;
16. Të identifikojë mjetet e pajisjet që përdoren në ambalazhim, paketim, marketimi dhe magazinim të mobilie;
17. Të shpjegojë rëndësinë e kontrollit për funksionalitet të mjeteve/pajisjeve të punës;
18. Të listojë mjetet përkatëse të kontrollit të cilësisë së punimit;

Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale

1. Të përdorë mjetet dhe instrumentet matëse, shënjuese e niveluese (analog dhe digjital);
2. Të përdorë veglat e dorës së punës (sharrë dore, daltë, zdrukth dore, morsetat shtrënguese etj.);
3. Të përdorë mjetet elektrike të dorës (trapano, vidator, zdrukth elektrik; frezë dore, zumpare orbitale me presion ajri, sharrë cirkulare dore etj.);
4. Të përdorë pajisjet e transportit të brendshëm, ventilimit, rrjetit elektrik etj., që përdoren në repartet e prodhimit të mobilie;
5. Të përdorë veglat dhe pajisjet e mpërshjes së instrumenteve prerës;
6. Të përdorë mjetet dhe pajisjet për ambalazhim, paketim, marketimi të mobilie;
7. Të kryejë kontrollin e cilësisë së punimit të veglave dhe pajisjeve;

Kriteret e vlerësimit

- Përdor saktë mjetet dhe instrumentet matëse e shënjuese sipas manualeve të përdorimit;
- Përdor saktë mjetet dhe instrumentet nivelues (analog dhe digital), sipas manualeve të përdorimit;
- Përdor mjetet, instrumentet dhe pajisjet për tharjen e lëndës drusore sipas manualeve të përdorimit;
- Përdor veglat e dorës së punës (sharrë dore, daltë, zdrukth dore, morsetat shtrënguese etj.) sipas manualeve të përdorimit;
- Përdor mjetet elektrike të dorës (trapano, vidator, zdrukth elektrik; frezë dore, zumpare orbitale me presion ajri, sharrë cirkulare dore etj.) sipas manualeve të përdorimit;
- Përdor saktë instrumentet e dorës për axhustim dhe relevim të mjeteve elektrike sipas manualeve të përdorimit;
- Përdor pajisjet e transportit të brendshëm, ventilimit, rrjetit elektrik etj., që përdoren në repartet e prodhimit të mobilie, sipas manualeve;
- Përdor mjetet dhe pajisjet për patinim, sipas funksionit të tyre;
- Përdor mjetet dhe pajisjet për bojatisje, sipas manualeve të përdorimit;
- Përdor mjetet dhe pajisjet për lustrim të sipërfaqeve të drurit, sipas manualeve të përdorimit;
- Përdor mjetet dhe pajisjet për imitim e drurit sipas manualeve;
- Përdor pajisjet e presimit sipas manualeve;
- Monton instrumentet prerës në pajisjet respektive, sipas procedurës;
- Përdor veglat dhe pajisjet e mprehjes së instrumenteve prerës sipas manualeve;
- Përdor mjetet e punës për procesin e vendosjes së elementeve dekorativë sipas manualeve;
- Përdor mjetet dhe pajisjet për ambalazhim, paketim, marketimi dhe magazinim të mobilie;
- Përdor sipas manualeve mjetet e kontrollit të cilësisë së punimit të veglave dhe pajisjeve;

NjN-03-III-0557-26 Makineritë dhe përdorimi i tyre

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të përshkruajë llojet e instrumenteve prerës sipas makinave përkatëse;
2. Të shpjegojë mënyrën e kontrollit të cilësisë së instrumenteve prerës;
3. Të shpjegojë mënyrën e montimit dhe regjistrimit të instrumenteve në makineri;
4. Të shpjegojë mënyrën e regjistrimit të makinerive sipas proceseve teknologjike;
5. Të shpjegojë tolerancat dhe axhustimin e detaleve;
6. Të shpjegojë rëndësinë e kontrollit të funksionimit të makinerive për shmangie të defekteve;
7. Të shpjegojë mënyrën e llogaritjes për shfrytëzimin optimal të makinerive;
8. Të shpjegojë rëndësinë e tharjes së drurit dhe ndikimin e lagështisë në vetitë dhe performancën e tij;
9. Të përshkruajë procesin e sharrimit;
10. Të identifikojë makinat për sharrim, llojet dhe teknikat e përdorimit të tyre;
11. Të përshkruajë procesin e zdrugimit;
12. Të identifikojë makinat plan dhe grosecë, llojet dhe teknikat e përdorimit të tyre;
13. Të përshkruajë procesin e bimit;
14. Të identifikojë makinat shpuese, llojet dhe teknikat e përdorimit të tyre;
15. Të përshkruajë procesin e frezimit/profilimit;
16. Të identifikojë makinat frezuese, llojet dhe teknikat e përdorimit të tyre;
17. Të përshkruajë procesin e thithëzimit;

18. Të identifikojë makinat tenonatriçe (dhe kavatriçe), llojet dhe teknikat e përdorimit të tyre;
19. Të përshkruajë procesin e bordimit;
20. Të identifikojë makinat bordatriçe, llojet dhe teknikat e përdorimit të tyre;
21. Të përshkruajë procesin e tornimit;
22. Të identifikojë makinat torno, llojet dhe teknikat e përdorimit të tyre;
23. Të përshkruajë procesin e zumparimit;
24. Të identifikojë makinat zumparuese, llojet dhe teknikat e përdorimit të tyre;
25. Të përshkruajë teknikat e përkuljes së drurit dhe materialeve me bazë druri;
26. Të identifikojë makinat dhe pajisjet për përkuljen e drurit dhe materialeve me bazë druri;
27. Të identifikojë makinat CNC, llojet dhe teknikat e përdorimit të tyre;
28. Të përshkruajë procesin e presimit;
29. Të identifikojë llojet e makinave për presim;
30. Të shpjegojë ndërtimin dhe funksionimin e presave mekanike, hidraulike, pneumatike;
31. Të përshkruajë procesin e imitimit të drurit;
32. Të identifikojë llojet e makinave të imitimit të drurit;
33. Të shpjegojë funksionimin e makinerive për montimin e objekteve të drurit;
34. Të identifikojë makineritë për montimin e objekteve të drurit;
35. Të përshkruajë funksionimin e makinerive për lustrim me sprucim dhe me zhytje.

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale

1. Të përdorë instrumentet prerës referuar teknologjisë së prodhimit dhe materialeve;
2. Të montojë/çmontojë pjesët përbërëse të makinerive;
3. Të regjistrojë parametrat e punimit të makinerive;
4. Të përdorë makineritë optimale;

Kriteret e vlerësimit

- Identifikon llojet e instrumentave prerës sipas makinave;
- Mat saktë parametrat cilësorë të instrumentave prerës (mprehja, dëmtimet etj.)
- Vlerëson parametrat cilësorë të instrumentave prerës në punimin e makinerisë;
- Monton dhe regjistron saktë instrumentet prerës në makina;
- Identifikon rreziqet nga montimi i gabuar;
- Regjistron parametrat e punimit të makinerive, sipas manualit;
- Përcakton saktë tolerancat e punimit dhe axhustimet;
- Realizon kontrollin bazë të funksionimit të makinerive;
- Llogarit saktë efikasitetin e përdorimit të makinerive;
- Vlerëson në mënyrë të plotë faktorët që ndikojnë në shfrytëzimin optimal të makinerive;
- Vlerëson saktë dinamikën e procesit të tharjes së drurit;
- Vlerëson saktë ndikimin e luhatjeve të përmbajtjes së lagështisë së materialit mbi deformimet dhe cilësinë e produktit;
- Kryen procesin e sharrimit, sipas makinave respektive;
- Mirëmban makinat e sharrimit, sipas kriterëve teknike;
- Kryen procesin e planimit sipas makinave respektive;
- Mirëmban makinat e planimit sipas kriterëve teknike;
- Kryen procesin e birimit sipas makinave respektive;
- Mirëmban makinat e birimit sipas kriterëve teknike;
- Kryen procesin e frezimit/profilimit sipas makinave respektive;

- Mirëmban makinat e frezimit;
- Kryen procesin e thithëzimit sipas makinave respektive;
- Mirëmban makinat e thithëzimit dhe shpjegon teknikat e përdorimit të tyre;
- Kryen procesin e bordimit sipas makinave respektive;
- Mirëmban makinat e bordimit dhe shpjegon teknikat e përdorimit të tyre;
- Kryen procesin e tornimit sipas makinave respektive;
- Mirëmban makinat e tornimit dhe shpjegon teknikat e përdorimit të tyre;
- Kryen procesin e kalibrim-zumparimit sipas makinave respektive;
- Mirëmban makinat e kalibruese dhe zumparuese dhe shpjegon teknikat e përdorimit të tyre;
- Kryen procesin e përkuljes së drurit dhe materialeve me bazë druri për prodhimin e mobilieve;
- Mirëmban makinat/pajisjet e përkuljes sipas kriterëve teknike;
- Përdor makinat CNC;
- Kryen procesin e presimit të drurit dhe materialeve me bazë druri për prodhimin e mobilieve;
- Mirëmban makinat/pajisjet e presimit sipas kriterëve teknike;
- Kryen procesin e imitimit të drurit;
- Mirëmban makinat/pajisjet e imitimit të drurit sipas kriterëve teknike;
- Kryen procesin e montimit të mobilieve;
- Mirëmban makinat/pajisjet e montimit të mobilieve sipas kriterëve teknike;
- Kryen lustrimin/lyerjen e mobilieve;
- Zbaton teknikat e ndryshme të proceseve të lustrimit/lyerjes së mobilieve;
- Mirëmban makinat/pajisjet e lustrimit/lyerjes së mobilieve sipas kriterëve teknike;

NjN-03-III-0558-26 Teknologjia e prodhimit të mobilieve

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të shpjegojë mënyrat e prerjes së drurit dhe materialeve me bazë druri;
2. Të shpjegojë radhën e proceseve në makineri;
3. Të përshkruajë radhën e montimit dhe rëndësinë e respektimit të saj;
4. Të shpjegojë mënyrën e ndarjes dhe sistemit të elementeve të punuar sipas përmasave dhe cilësisë;
5. Të shpjegojë mënyrën e montimit të nënasambleve;
6. Të shpjegojë mënyrën e montimit të aksesorëve;
7. Të listojë llojet e defekteve në elementët e punuar dhe mënyrat e identifikimit të tyre;
8. Të listojë llojet e defekteve të montimit;
9. Të përshkruajë mënyrën e eliminimit të defekteve të konstatuara gjatë montimit;
10. Të përshkruajë mënyrat e riparimit të defekteve tek elementet e dëmtuara;
11. Të përshkruajë etapat e procesit të restaurimit;
12. Të shpjegojë metodat e inspektimit të produktit përfundimtar dhe rëndësinë e tyre;
13. Të shpjegojë llojet e paketimit, mënyrat dhe rëndësinë e tyre;
14. Të shpjegojë mënyrat e ambalazhimit dhe marketimit si dhe rëndësinë e tyre.

Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale

1. Të realizojë prodhimin e elementeve/detaleve;
2. Të realizojë montimin e aksesorëve;
3. Të kryejë montimin e mobilieve;
4. Të kryejë kontrollin për cilësinë e produktit;

5. Të realizojë ambalazhimin, paketimin dhe marketimin.

Kriteret e vlerësimit

- Aplikon metodën e prerjes në përputhje me llojin e materialit dhe kërkesat e punimit;
- Zbaton proceset teknologjike në makineri, sipas radhës së punës;
- Zbaton proceset e punës duke shmangur defektet;
- Monton mobilet sipas rendit të saktë referuar dokumentacionit teknik;
- Ndan elementet e punuar sipas dimensioneve, formës dhe cilësisë së përpunimit;
- Sistemon elementet në mënyrë të rregullt dhe të identifikueshme për procesin në vazhdim;
- Kontrollon elementet e përzgjedhur për defekte të mundshme;
- Përdor mjetet dhe teknikat e duhura për realizimin e lidhjeve;
- Kontrollon saktësinë dhe qëndrueshmërinë e nënasambleve të realizuara;
- Monton aksesorët sipas dokumentacionit teknik;
- Verifikon funksionalitetin dhe pozicionimin korrekt pas montimit;
- Identifikon defektet në montim përmes kontrollit vizual dhe mjeteve matëse;
- Analizon shkaqet e mundshme që çojnë në krijimin e defekteve;
- Dallon gabimet në lidhje, pozicionim dhe fiksime të elementeve;
- Vlerëson ndikimin e këtyre defekteve në cilësinë përfundimtare të produktit;
- Korrigjon defektet e konstatuara, sipas llojit dhe shkallës së dëmtimit;
- Kontrollon rezultatin pas ndërhyrjes për të siguruar cilësinë e kërkuar;
- Zbaton kriteret e inspektimit për të verifikuar përputhshmërinë me standardet;
- Dokumenton dhe raporton rezultatet e kontrollit në mënyrë të qartë;
- Realizon ambalazhimin, paketimin dhe marketimin në varësi të produktit dhe destinacionit.

NjN-03-III-0559-26 Punime të strukturës mbajtëse dhe të pjesës së butë në mobilet e tapicuara

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të përshkruajë rolin dhe funksionin e strukturës mbajtëse dhe ndërveprimin e saj me pjesën e butë të tapicerisë;
2. Të identifikojë elementet përbërës të strukturës mbajtëse dhe komponentët e tapicerisë;
3. Të dallojë llojet e strukturave mbajtëse sipas tipologjisë së mobilieve dhe përdorimit të tyre funksional.
4. Të përshkruajë teknikat e montimit të strukturës duke siguruar qëndrueshmëri dhe rezistencë mekanike;
5. Të analizojë përputhshmërinë e strukturës me projektin teknik dhe kërkesat funksionale të mobilies;
6. Të vlerësojë rëndësinë e dimensionimit të saktë të elementeve strukturorë në cilësinë e produktit final;
7. Të përshkruajë parimet bazë të ndërtimit të një strukture të fortë dhe të qëndrueshme;
8. Të identifikojë dhe analizojë ngarkesat që veprojnë mbi strukturën dhe ndikimin e tyre në përdorim;
9. Të shpjegojë shkaqe e dëmtimit të strukturës mbajtëse dhe të tapicerisë;
10. Të përshkruajë mënyrat e përforcimit të strukturës mbajtëse;
11. Të shpjegojë procesin e montimit sipas radhës teknologjike të punës;

12. Të analizojë lidhjen funksionale ndërmjet strukturës mbajtëse dhe shtresave të tapicerisë;
13. Të shpjegojë ndikimin e kushteve të ambientit (lagështia, temperatura) në strukturë dhe materiale;
14. Të shpjegojë procedurat e kontrollit të cilësisë gjatë procesit të prodhimit;
15. Të shpjegojë parapërgatitjen e materialeve të tapicerisë;
16. Të shpjegojë teknikat e prerjes dhe përgatitjes së materialeve të tapicerisë me saktësi;
17. Të analizojë materialet mbushëse dhe veshëse sipas funksionit dhe cilësisë;
18. Të përshkruajë teknikat e mbushjes për sigurimin e komoditetit dhe formës ergonomike të mobilies së tapicuar;
19. Të përshkruajë procesin e veshjes së mobilies sipas standardeve profesionale dhe estetike;
20. Të identifikojë defektet më të zakonshme në tapiceri (rrudha, ulje, deformime);
21. Të shpjegojë shkaqet e dëmtimit të materialeve të tapicerisë dhe mënyrat e parandalimit të tyre;
22. Të shpjegojë teknikat e fiksimit të skeletit me materialet mbushëse dhe shtresat e tapicerisë;
23. Të analizojë faktorët që ndikojnë në komoditetin e mobilies (trashësi, fortësi, elasticiteti);
24. Të identifikojë materialet ekologjike, natyrore dhe sintetike në tapiceri;
25. Të analizojë aspektet ergonomike në projektimin dhe realizimin e mobilies së tapicuar.

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale

1. Të përcaktojë formën, materialet dhe dimensionet e mobilies së tapicuar;
2. Të realizojë prodhimin e strukturës mbajtëse të mobilies së tapicuar;
3. Të realizojë bashkimin e strukturës mbajtëse me materialet e buta (sfungjer, fibra etj);
4. Të realizojë veshjen e mobilies me tapiceri;
5. Të kryejë kontrollin cilësor të mobilies së tapicuar;

Kriteret e vlerësimit

- Kryen matje të sakta në objekt;
- Harton skicat në mënyrë manuale ose duke aplikuar programe kompjuterike;
- Zbërthen saktë skicat teknike;
- Krahason dimensionet reale me projektin;
- Bën korrigjimet e nevojshme të projektit;
- Llogarit saktë materialet sipas nevojës;
- Përcakton mënyrën e lidhjes së nyjeve bashkuese të strukturës mbajtëse, sipas projektit.
- Përgatit pjesët për montim sipas projektit duke përdor saktë veglat e punës;
- Ndërton çdo element të strukturës mbajtëse dhe mbështetëse, sipas projektit;
- Përzgjedh materialet e duhura;
- Përdor materialet e tapicerisë (sfungjer, fibra, pëlhurë etj.), sipas performancës së kërkuar;
- Përzgjedh strukturën e përshtatshme të tapicerisë sipas kërkesës dhe projektit;
- Mat me saktësi elementet e bazës dhe të pjesës së butë;
- Respekton tolerancat teknike të projektit;
- Shmang gabime gjatë prerjes;
- Përgatit pjesët sipas përmasave;
- Realizon lidhje të sakta në kënde;
- Identifikon pikat ku ushtrohet presion duke analizuar efektin e peshës dhe përdorimit,
- Përcakton zonat më të ndjeshme;
- Përforon strukturën, bazuar për kërkesat për performacë të lartë;

- Identifikon dëmtime të mundshme (çarje, lirime, deformime) strukturore dhe estetike;
- Analizon shkaqet e dëmtimeve;
- Merr masa për eliminimin e dëmtimeve;
- Teston qëndrueshmërinë pas ndërhyrjes;
- Përfundon strukturën mbajtëse duke respektuar kërkesat e porosisë dhe/ose standardet;
- Vendos shtresat mbi strukturë sipas kërkesave teknologjike;
- Siguron ngjitje/fiksim të mirë;
- Shmang boshllëqet ose deformimet në shtresën e butë;
- Kontrollon uniformitetin në mënyrë vizuale.
- Siguron kushte të përshtatshme të ruajtje së materialeve;
- Përzgjedh materialet e tapicerisë sipas projektit;
- Përgatit materialet e tapicerisë referuar kërkesave teknologjike;
- Shënon saktë vijat e prerjes;
- Realizon prerje të pastra dhe të sakta me veglat përkatëse;
- Krijon formë ergonomike duke garantuar komoditet;
- Vendos pëlhurën në drejtim korrekt;
- Shtrin materialin pa rrudha duke e fiksuar në mënyrë të rregullt;
- Identifikon defektet vizuale dhe funksionale;
- Analizon shkaku e defekteve;
- Realizon ndërhyrje korrigjuese;
- Vlerëson vizualisht mobilien në përdorim, sipas butësisë dhe elasticitetit;
- Kontrollon cilësinë e punimeve në çdo fazë.

NjN-03-III-0560-26 Riparimi i defekteve dhe restaurimi i mobilie

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të listojë llojet e defekteve të mundshme të elementëve/pjesëve të mobilies dhe shkaqet e tyre;
2. Të shpjegojë mënyrat e riparimit të defekteve tek elementët/pjesët e dëmtuar;
3. Të shpjegojë mënyrën e riparimit të defekteve, në repartin e montimit, të veshjes së brinjëve me tenie, rimeso, plastikë etj.;
4. Të shpjegojë procesin parapërgatitor për restaurim (pastrimi, vlerësimi, përzgjedhja e materialeve);
5. Të përshkruajë teknikat bazë të restaurimit të pjesëve prej druri;
6. Të shpjegojë rëndësinë dhe mënyrën e dezinfektimit me antiseptikë të objekteve të përdorura prej druri;
7. Të shpjegojë procesin e cenoblimit dhe rëndësinë e tij;
8. Të shpjegojë rëndësinë dhe mënyrat e rimesimit, patinimit dhe lustrimit, të plotë apo të pjesshëm gjatë restaurimit;
9. Të listojë llojet dhe mënyrat e riparimeve të elementëve të dëmtuar/vjetëruar të tapicerisë;
10. Të shpjegojë rëndësinë dhe mënyrat e zëvendësimit të aksesorëve të dëmtuar/vjetëruar;
11. Të përshkruajë llojet e defekteve të mundshme gjatë restaurimit.

Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale

1. Të riparojë defektet në mobiliat e përdorura/prodhuara;
2. Të kryejë vlerësimin e gjendjes së mobilie për restaurim;

3. Të realizojë pastrimin e zonave të dëmtuara
4. Të realizojë riparimin e pjesëve të dëmtuara;
5. Të realizojë dezinfektimin e mobilie.

Kriteret e vlerësimit

- Identifikon defektet në elementët/pjesët e mobiljes (çarje, deformime, fryrje, dëmtime sipërfaqësore etj.), si dhe shkaqet e tyre;
- Identifikon defektet dhe materialet në veshjen e brinjëve;
- Riparon defektet në mobilje (mbushje, zëvendësim, ngjitje etj.), sipas procedurës;
- Kryen vlerësimin e mobiljeve për restaurim (pastrim, vlerësim degradimi, përzgjedhje materiale etj.);
- Zbaton saktë teknikat bazë të restaurimit të drurit (pastrim, riparim, rifinim etj.), sipas procedurës;
- Realizon dezinfektimin me antiseptikë, sipas procedurës;
- Realizon cenoblimin e sipërfaqes që duhen restauruar;
- Realizon rimesim, patinim dhe lustrim të pjesëve që duhen restauruar sipas procedurës;
- Identifikon dëmtimet/degradimet në tapiceri (shkëputje, konsum, deformim etj.);
- Riparon tapicerinë me mjetet e nevojshme;
- Riparon (kur është e mundur) dhe zëvendëson aksesoret e dëmtuar;
- Vlerëson defektet që mund të lindin gjatë ose për shkak të restaurimit.

NjN-24-III-0492-26 Sipërmarrje, komunikim dhe edukim karriere

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të shpjegojë parimet bazë të Kodit të Punës dhe legjislacionit përkatës që lidhet me aktivitetin profesional në mobiliери/tapiceri;
2. Të listojë llojet kryesore të dokumentacionit ligjor dhe financiar që përdoret në ushtrimin e aktivitetit (kontrata, fatura, raporte, regjistra);
3. Të përshkruajë format dhe mënyrat e përpilimit, ruajtjes dhe arkivimit të dokumentacionit sipas rregullave përkatëse;
4. Të shpjegojë mënyrat e llogaritjes së nevojave për materiale dhe të planifikimit të grafikut të kohës së punës;
5. Të përshkruajë mënyrën e regjistrimit të të dhënave në faturë dhe rëndësinë e saktësisë së tyre;
6. Të shpjegojë mënyrat dhe elementët e përgatitjes së një oferte për punime/shërbime;
7. Të listojë llojet kryesore të raportimeve financiare (raporte shpenzimesh, të ardhurash, bilance të thjeshta);
8. Të përshkruajë mënyrat e informimit nga tregu në lidhje me çmimet dhe cilësinë e mjeteve, materialeve dhe pajisjeve të punës;
9. Të përshkruajë elementët bazë të llogaritjes së kostos për mjete, materiale dhe pajisje pune;
10. Të identifikojë komponentët e kostos (kosto direkte dhe indirekte);
11. Të shpjegojë mënyrën e përlllogaritjes së kostos së prodhimit për një produkt mobiliери/tapicerie;
12. Të dallojë llojet kryesore të faturave (faturë tatimore, faturë e thjeshtë, faturë shoqëruese);
13. Të përshkruajë elementët përbërës të një fature (data, përshkrimi, sasia, çmimi, TVSH);
14. Të shpjegojë procedurën e plotësimit të faturave në mënyrë korrekte;
15. Të përshkruajë përmbajtjen e një oferte për punime/shërbime;

16. Të identifikojë elementët kryesorë të një oferte (përshkrimi i punës, çmimi, afatet, kushtet);
17. Të shpjegojë rëndësinë e përgatitjes së ofertave për klientët;
18. Të përshkruajë konceptin e inventarit dhe rëndësinë e tij në biznes;
19. Të identifikojë mënyrat e dokumentimit të inventarit (regjistra, lista, sisteme elektronike);
20. Të shpjegojë parimet bazë të menaxhimit të inventarit;
21. Të përshkruajë procedurat e furnizimit me materiale dhe pajisje;
22. Të identifikojë dokumentacionin e nevojshëm për furnizim (porosi, kontrata, fatura);
23. Të shpjegojë hapat kryesorë të procesit të furnizimit;
24. Të dallojë mënyrat e blerjes së mjeteve dhe materialeve (blerje direkte, me porosi, online);
25. Të përshkruajë kriteret për përzgjedhjen e furnitorëve;
26. Të shpjegojë elementët e llogaritjes së çmimit për shërbimet/punimet e ofruara;
27. Të identifikojë faktorët që ndikojnë në çmim (kosto, tregu, konkurrenca, cilësia);
28. Të përshkruajë konceptin e fitimit dhe marzhit të fitimit;
29. Të dallojë llojet e dokumenteve për dorëzimin e punimeve/shërbimeve (procesverbal, fletë-dorëzim, faturë);
30. Të përshkruajë përmbajtjen e dokumenteve të dorëzimit;
31. Të shpjegojë rëndësinë e dokumentimit korrekt të dorëzimit të punës;
32. Të përshkruajë konceptin e marketingut dhe rolin e tij në biznes;
33. Të identifikojë teknikat bazë të marketingut (promovimi, reklama, komunikimi me klientin);
34. Të shpjegojë rëndësinë e kënaqësisë së klientit dhe imazhit të biznesit;
35. Të përshkruajë mënyrat e promovimit të shërbimeve në mobilieri/tapiceri (rrjete sociale, rekomandime, ekspozim);
36. Të përshkruajë mënyrat e analizimit të vetvetes në aspektin profesional (pikat e forta, dobësitë, aftësitë dhe interesat);
37. Të shpjegojë rëndësinë e vetëvlerësimit në përmirësimin e performancës në punë;
38. Të identifikojë metodat e zhvillimit profesional (mësim gjatë gjithë jetës, trajnime, praktikë, mentorim);
39. Të përshkruajë konceptin e zhvillimit të karrierës dhe fazat e tij;
40. Të shpjegojë rëndësinë e planifikimit të karrierës në fushën e mobilierisë/tapicerisë;
41. Të identifikojë aftësitë e nevojshme për zhvillim profesional në tregun e punës;
42. Të shpjegojë rëndësinë e përdorimit të teknologjisë në rritjen e cilësisë dhe efikasitetit të punës;
43. Të përshkruajë mënyrat e transmetimit të njohurive dhe eksperiencës tek bashkëpunëtorët në vendin e punës;
44. Të shpjegojë rëndësinë e komunikimit profesional në transferimin e njohurive teknike;
45. Të identifikojë mënyrat e aplikimit të teknikave të reja në proceset e punës;
46. Të përshkruajë rëndësinë e inovacionit në përmirësimin e produkteve dhe shërbimeve;
47. Të dallojë llojet e panairove profesionale dhe ekspozitave industriale;
48. Të shpjegojë rolin e panairove dhe ekspozitave në promovimin e produkteve dhe krijimin e kontakteve profesionale;
49. Të përshkruajë rëndësinë e kurseve teknike në përmirësimin e aftësive praktike dhe teorike;
50. Të përshkruajë rëndësinë e përshtatjes me ndryshimet teknologjike në profesion;
51. Të identifikojë burimet e informacionit për zhvillim profesional (internet, manuale, kurse, kolegë, institucione);
52. Të shpjegojë rëndësinë e punës në ekip në zhvillimin profesional dhe shkëmbimin e eksperiencave;

53. Të përshkruajë mënyrat e përmirësimit të vazhdueshëm të aftësive personale dhe profesionale;
54. Të identifikojë mundësitë e punësimit dhe zhvillimit në sektorin e mobilierisë dhe tapicerisë.
55. Të përshkruajë konceptin e komunikimit dhe metodat kryesore të tij në një mjedis profesional;
56. Të shpjegojë parimet bazë të punës në grup dhe rëndësinë e bashkëpunimit në realizimin e detyrave;
57. Të dallojë rregullat bazë të komunikimit verbal dhe jo verbal;
58. Të shpjegojë parimet e Kodit të Etikës dhe rëndësinë e zbatimit të tij në vendin e punës;
59. Të përshkruajë metodat bazë të zgjidhjes së problemeve dhe rolin e mendimit kritik në situata pune;
60. Të identifikojë bashkëpunëtorët kryesorë në veprimtarinë profesionale dhe rolin e secilit;
61. Të shpjegojë përdorimin e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK) në komunikimin profesional;
62. Të përshkruajë rëndësinë e përdorimit korrekt të terminologjisë profesionale në mobilieri/tapiceri;
63. Të shpjegojë rëndësinë e ruajtjes së të dhënave konfidenciale dhe mbrojtjes së informacionit;
64. Të përshkruajë rëndësinë e respektimit të parimeve të barazisë dhe mosdiskriminimit (gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare etj.) në mjedisin e punës.

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale

1. Të zbatojë legjislacionin e fushës dhe rregullat bazë të punës në aktivitetin profesional;
2. Të kryejë llogaritje të kostove, çmimeve, materialeve etj. për punime mobilierie/tapicerie.
3. Të plotësojë/regjistrojë dokumente financiare;
4. Të kryejë procedurat e furnizimit;
5. Të përgatitë oferta;
6. Të plotësojë dokumentet e dorëzimit dhe inventarit të mallrave dhe shërbimeve;
7. Të kryejë marketing dhe promovim të shërbimeve;
8. Të zbatojë metoda të zhvillimit profesional;
9. Të zbatojë etikën profesionale dhe komunikimin në vendin e punës;
10. Të bashkëpunojë/punojë në grup në mënyrë efektive;
11. Të përdorë komunikimin digjital dhe dokumentacionin profesional;
12. Të respektojë rregullat e konfidencialitetit dhe sigurisë së informacionit.

Kriteret e vlerësimit

- Zbaton legjislacionin e fushës dhe rregullat bazë të punës;
- Plotëson kontrata pune ose shërbimi sipas modelit të dhënë;
- Identifikon dokumentet financiare (fatura, regjistra, raporte);
- Përgatit dokumentacionin sipas rregullave të arkivimit;
- Organizon dhe arkivon dokumente ligjore (kontratë, faturë, raport), sipas rregullave;
- Zbaton ruajtjen fizike ose elektronike të dokumenteve;
- Llogarit saktë sasinë e materialeve për një punim në mobilieri/tapiceri;
- Llogarit saktë koston totale të produktit;
- Përgatit një plan pune me hapa dhe kohëzgjatje për një detyrë konkrete;
- Përcakton çmimin dhe marzhin e fitimit;
- Plotëson fatura me të gjithë elementët (datë, sasi, çmim, TVSH);
- Regjistron saktë të dhënat e klientit dhe produktit në faturë;
- Korrigjon gabime në një faturë të pasaktë;

- Regjistron të dhënat pa gabime;
- Harton një ofertë për punime/shërbime duke përfshirë elementët kryesorë (përshkrim, çmim, afate, kushte etj.);
- Prezanton ofertën në mënyrë të strukturuar për klientin;
- Harton raporte të thjeshta financiare (shpenzime, të ardhura) duke paraqitur të dhëna të sakta dhe të strukturuar;
- Bën analizë të çmimeve dhe cilësisë së materialeve në treg;
- Përzgjedh furnitorë sipas kritereve;
- Ndjek procedurat e furnizimit (porosi, kontratë, faturë);
- Regjistron materiale në lista/regjistra;
- Përgatit një listë porosie për materiale dhe pajisje;
- Kryen procedurat e blerjeve;
- Plotëson me korrektësi dokumente të dorëzimit (procesverbal, fletë-dorëzim);
- Regjistron materialet në një listë inventari;
- Kryen kontroll fizik të stokut dhe krahason me regjistrin;
- Përditëson të dhënat e inventarit sipas ndryshimeve;
- Propozon mënyra konkrete promovimi duke përdorur teknika promovimi (rrjete sociale, reklama);
- Krijon një përshkrim të thjeshtë të shërbimit për klient;
- Përdor kanale promovimi (p.sh. rrjete sociale ose prezantim);
- Prezanton një shërbim në mënyrë të strukturuar për klientin;
- Jep vlerësim realist për veten;
- Identifikon pikat e forta dhe dobësitë personale në punë;
- Harton një plan të thjeshtë për përmirësim personal;
- Transmeton në kohë dhe në mënyrë të qartë teknika të reja duke mbështetur bashkëpunëtorët;
- Zgjedh dhe ndjek trajnime të përshtatshme në funksion të zhvillimit të vet profesional.
- Zbaton rregullat e etikës në punë dhe komunikim;
- Jep shembuj konkret nga situata pune duke përdorur metodat e komunikimit verbal, jo verbal, shkresor, digjital;
- Komunikon me kolegët dhe bashkëpunëtorët duke përdorur terminologji bazë profesionale;
- Merr pjesë aktive në detyrë në grup;
- Respekton rolet e anëtarëve të grupit;
- Ndiemon dhe bashkëpunon me të tjerët;
- Ndjek udhëzimet dhe kontribuon në vendimmarrje;
- Zgjidh konflikte të thjeshta në mënyrë pozitive;
- Përdor email, mesazhe profesionale ose platforma digjitale;
- Përdor terminologji profesionale në komunikim digjital;
- Harton përshkrime pune me gjuhë profesionale;
- Zbaton rregullat për ruajtjen e informacionit konfidencial në punë (klientë, çmime, projekte);
- Zbaton rregulla mbrojtjeje (fjalëkalime, mosndarje pa leje, ruajtje dokumentesh etj.);
- Respekton parimet e barazisë dhe mosdiskriminimit;
- Paraqet sjellje korrekte në situata të diskriminimit duke respektuar barazi dhe respekt;

NjN-03-III-0561-26 Siguria në punë dhe mbrojtja e mjedisit në mobiliери dhe tapiceri

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të shpjegojë standardet dhe legjislacionin shqiptar për rregullat e sigurimit teknik në vendin e punës;
2. Të përshkruajë rëndësinë e përdorimit të manualeve të mjeteve dhe pajisjeve të punës;
3. Të identifikojë procedurat dhe mjetet për dhënien e ndihmës së parë në rast aksidenti;
4. Të interpretojë sinjalistikat dhe shenjat paralajmëruese në mjedisin e punës;
5. Të përshkruajë procedurat e evakuimit në raste emergjence;
6. Të shpjegojë përdorimin dhe funksionin e pajisjeve të mbrojtjes nga zjarri (MZSH);
7. Të përshkruajë masat e sigurisë gjatë përdorimit të solucioneve me përmbajtje kimike;
8. Të shpjegojë konceptin dhe karakteristikat e zhvillimit të qëndrueshëm;
9. Të përshkruajë rregullat e mbrojtjes së mjedisit për ndarjen dhe menaxhimin e mbetjeve;
10. Të identifikojë rregulloret përkatëse për depozitimin e mbetjeve;
11. Të shpjegojë rëndësinë e identifikimit dhe raportimit të mosfunksionimit të mjeteve dhe pajisjeve të punës;
12. Të përshkruajë rregullat e sigurisë për ruajtjen dhe magazinimin e materialeve;
13. Të identifikojë pajisjet mbrojtëse personale dhe funksionin e tyre në sigurinë në punë;
14. Të shpjegojë rëndësinë e kontrollit të funksionalitetit të pajisjeve mbrojtëse personale;
15. Të përshkruajë pajisjet e thjeshta për kontrollin e rrjetit elektrik;
16. Të shpjegojë mënyrat dhe rëndësinë e verifikimit të sigurisë së kabllave dhe pajisjeve elektrike;
17. Të përshkruajë rëndësinë e testimit të pajisjeve elektrike për funksionim të sigurt;
18. Të dallojë llojet e tabelave të kufizimit dhe sinjalistikës për sigurinë teknike;
19. Të shpjegojë protokollet e duhura të veprimit në raste të gjendjeve të jashtëzakonshme.

Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale

1. Të zbatojë rregullat e sigurisë dhe legjislacionin për sigurinë në punë;
2. Të zbatojë procedurat e ndihmës së parë dhe për emergjencat;
3. Të respektojë sinjalistikën dhe rregullat e sigurisë;
4. Të përdorë pajisjet e mbrojtjes dhe sigurisë nga zjarri (MZSH);
5. Të zbatojë procedurat gjatë punës me materiale dhe solucione me përmbajtje kimike;
6. Të kryejë raportim dhe mirëmbajtje të pajisjeve të sigurisë;
7. Të zbatojë procedurat për verifikimin e kabllave dhe pajisjeve elektrike;
8. Të zbatojë procedurat për mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e qëndrueshëm;
9. Të zbatojë procedurat në situata emergjente.

Kriteret e vlerësimit

- Identifikon standardet dhe aktet ligjore kryesore për sigurinë në punë;
- Zbaton udhëzimet e manualeve në mënyrë të saktë të mjeteve dhe pajisjeve të punës;
- Zgjedh mjetet për dhënien e ndihmës së parë në rast aksidenti;
- Zbaton saktë procedurat e dhënies së ndihmës së parë sipas protokollit;
- Dallon shenjat e sigurisë në mjedisin e punës;
- Reagon saktë në situata praktike sipas sinjalistikës;

- Përdor tabelat e kufizimit dhe sinjalistikën në mënyrë të përshtatshme
- Zbaton saktë procedurat në raste evakuimi duke respektuar sinjalistikën;
- Përdor pajisjet kundër zjarrit në mënyrë të sigurt;
- Zbaton masat mbrojtëse gjatë përdorimit praktik të solucioneve me përmbajtje kimike;
- Organizon materialet dhe solucionet sipas standardeve të sigurisë;
- Zbaton procedurat për ndarje të saktë të mbetjeve;
- Zbaton rregulloret për kryerjen e depozitimit të mbetjeve;
- Zbaton procedurat e mbrojtjes së mjedisit;
- Zbaton rregullat e përdorimit efikas të burimeve të lëndëve të para dhe atyre të energjisë;
- Zbaton udhëzimet teknike për ruajtjen dhe përdorimin e materialeve referuar minimizimit të rrezikut për ndotjen e mjedisit;
- Dokumenton dhe ndjek procedurën e plotë të raportimit në rast mosfunksionimi të të mjeteve dhe pajisjeve të punës;
- Zgjedh dhe përdor pajisjet mbrojtëse personale të duhura;
- Kontrollon vizualisht pajisjet e MZSH për identifikimin e dëmtimeve dhe problemeve;
- Përdor saktë pajisjet e MZSH-së;
- Përdor pajisjet për matje të thjeshta për kontrollin elektrik;
- Kryen verifikim të kabllave dhe pajisjeve elektrike;
- Zbaton masa parandaluese në rastë të mundshme dëmtimesh;
- Kryen teste bazë të pajisjeve elektrike sipas udhëzimeve;
- Zbaton protokollet në gjendje të jashtë zakonshme;
- Reagon saktë dhe në kohë në simulime praktike të situatave të jashtëzakonshme.

Njësitë e të nxënit, peshat dhe kodet përkatëse:

Nr.	Njësi të nxëni	Peshat në %	Kodet
1	Klasifikimi dhe dizajni i mobilieve	3	NjN-03-III-0552-26
2	Parapërgatitja për prodhimin e produktit	9	NjN-03-III-0553-26
3	Planifikimi dhe organizimi i vendit të punës në mobilieri dhe tapiceri	6	NjN-03-III-0554-26
4	Materialet për prodhimin e mobilieve	12	NjN-03-III-0555-26
5	Mjetet, pajisjet dhe teknikat e përdorimit të tyre	9	NjN-03-III-0556-26
6	Makineritë dhe përdorimi i tyre	18	NjN-03-III-0557-26
7	Teknologjia e prodhimit të mobilieve	18	NjN-03-III-0558-26
8	Punime të strukturës mbajtëse dhe të pjesës së butë në mobilet e tapicuara	15	NjN-03-III-0559-26
9	Riparimi i defekteve dhe restaurimi i mobilieve	8	NjN-03-III-0560-26
10	Sipërmarrje, komunikim dhe edukim karriere	2	NjN-24-III-0492-26
11	Siguria në punë dhe mbrojtja e mjedisit në mobilieri dhe tapiceri	2	NjN-03-III-0561-26
	Totali	100	

Modalitetet e vlerësimit

Me vlerësim kuptojmë procesin gjatë të cilit mbliidhen të dhëna dhe gjykohet për vlerën e arritjes së një rezultati të nxëni (RN), mbi bazën e kritereve të caktuara.

Për vlerësimin mund të përdoren një shumëllojshmëri metodash standarde dhe inovatore.

Individi i nënshtrohet vlerësimit të vazhduar, përmbledhës dhe vlerësimit përfundimtar për kualifikimet formale që ofrohen në ofrues të akredituar.

Individi vlerësohet për shkallën e përvetësimit të kompetencave të përgjithshme dhe profesionale, të nevojshme për të punuar në veprimtari të ndryshme profesionale që operojnë në fushën përkatëse dhe vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së RN për realizimin e tërësisë së proceseve duke mbajtur evidenca për qëllime dokumentimi.

Realizimi i pranueshëm do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të specifikuar.

Dhënia e rezultatit të vlerësimit bëhet sipas kuadrit ligjor në fuqi.

Kompetencat e përgjithshme vlerësohen të integruara si pjesë e vlerësimit të njësive të të nxënit.

Individit i lind e drejta të certifikohet për njësitë të nxëni specifike, si një kualifikim i pjesshëm sipas kuadrit ligjor në fuqi.

Informacion shtesë

Kualifikimet e plota ose të pjesshme profesionale mund të përftohen nëpërmjet këtyre formave:

- a) ndjekjes së arsimit profesional me bazë shkollën;
- b) ndjekjes së kurseve profesionale, ku përfshihen edhe praktikat profesionale në ndërmarrje apo forma të tjera të mësim nxënies praktike;
- c) regjistrimit si nxënës, duke u punësuar në një ndërmarrje (forma e dyfishtë);
- ç) njohjes të të nxënit të mëparshëm informal dhe joformal;
- d) njohjes të të nxënit të përfutur jashtë vendit;
- dh) formave të tjera të përcaktuara me ligj.

SHËNIM

Shpjegime të kodit të kualifikimit: C3-III-26

C - Shkronja që identifikon fushën e kualifikimit profesional

3 - Numri që identifikon profilin e kualifikimit përkatës

III - Shifra që identifikon nivelin sipas KSHK

26 - Shkurtimi i vitit kalendarik kur është hartuar/rishikuar kualifikimi profesional

Shpjegime të kodit të njësisë së të nxënit: NjN-03-III-0552-26

NjN – Shkronjat që tregojnë se kodi i referohet Njësive të të Nxënit

03 – Numri që identifikon fushën e Njësisë së të Nxënit

III – Shifra që tregon nivelin e Njesisë së të Nxënit në strukturën e KSHK

0552 – Numri rritës progresiv që tregon gjendjen e Njësive të të Nxënit në ditën e hartimit përkatës

26 – Shkurtimi i vitit kalendarik kur është hartuar/rishikuar Njësia e të Nxënit